



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic
of Kosovo

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo
Prosecutorial Council

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

në mes të

KËSHILLIT GJYQËSOR I KOSOVËS

dhe

KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Duke u bazuar në kompetencat ligjore të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Duke pasur parasysh që Këshilli Prokurorial i Kosovës posedon objekt në Komunën Pejë në adresën: Rr. Eliot Engel, Nr. 08 - Pejë.

Duke pasur parasysh që objekti ekzistues nuk shfrytëzohet nga Prokuroria Themelore në Pejë, pasi që është vendosur në objektin e ri.

Duke pasur parasysh që Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka objekt për Gjykatën Themelore në Pejë.

Duke pasur parasysh që objekti i Prokurorisë Themelore në Pejë, i plotëson nevojat për Gjykatën Themelore në Pejë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës pajtohen që:

Ti ipet në shfrytëzim objekti i Prokurorisë Themelore në Pejë, Gjykatës Themelore të Pejës - Divizionit për kundërvajtje.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është zgjidhja e përkohshme e sigurimit të hapësirave për nevojat e Gjykatës Themelore në Pejë – Divizioni për Kundërvajtje.

Neni 2 Detyrimet e Këshilli Prokurorial i Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës do të jap në shfrytëzim objektin e Prokurorisë Themelore në Pejë, në adresë: Rr. Eliot Engel, Nr. 08 – Pejë.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do t'i dorëzojë objektin Këshillit Gjyqësor të Kosovës në gjendje të rregullt dhe pa asnjë obligim ndaj palëve tjera.

Neni 3 Detyrimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të shfrytëzojë objektin e Prokurorisë Themelore në Pejë, me mirëbesim.

Obligohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës që për çdo dëm eventual të shkaktuar të bëjë riparimin e tij.

Neni 4 Kohëzgjatja

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës pajtohen që kjo marrëveshje të zgjas deri me datë 31 dhjetor 2020, me mundësi vazhdimi pas paralajmërimit prej 60 ditësh nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Neni 5 Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin e të dy palëve.



Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kryesues
Skender ÇOÇAJ



Këshilli Prokurorial i Kosovës

Kryesues
Bahri HYSANI